REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:113060
Datë: 06.02.2020
Numri i dokumentit: 00816046

P.nr.187/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit V.R. nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.1963/2019 të dt.17.04.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 06.02.2020 në praninë e Prokurorit të shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të pandehurit V.R., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

V.R., nga babai M. dhe nëna H. e vajzërisë Xh., i lindur më dt.*data e lindjes...*, nga fshati D., Komuna e P. ku dhe jeton , me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomiko-sociale, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

Me datë 30.08.2018 në shtëpinë e tij në rrugën "..." në P., me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm i pandehuri e ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizim të furnizuesit përkatës – KEDS-it, ashtu që i njëjti ka bërë lidhje direkte në rrjet pa njehësor elektrik, ashtu që ka pamundësuar matjen e energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS-it i ka shkaktuar dëm material.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 si dhe nenin 314 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 369, 370, 453, 463 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

2019:113061

Të pandehurin **V.R.**, e dënon me dënim me gjobë në vlerë prej **100 (njëqind) eurosh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **1 (një) viti**, në qoftë se i akuzuari gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguaj shpenzimet paushallë gjyqësor në shumën prej **20 (njëzetë) euro**, brenda afatit prej 15 ditësh, në emër të kompensimit të viktimave të paguajë shumën prej **30 (tridhjetë) euro**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri V.R., që t'ia kompensoi të dëmtuarës KEDS në Prishtinë, dëmin e shkaktuar me vepër penale në vlerë prej 52.75 €uro, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosje të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me PP.II.nr.1963/2019 të dt.17.04.2019, ka akuzuar të pandehurin V.R. nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 06.02.2020, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i pandehuri V.R.

I pandehuri V.R. deklaron se: E pranojë fajësinë, është e vërtetë se tri ditë jam kanë pa njehësor, kërkesën e kam bërë me kohë për me ma pru njehësorin ata janë vonuar se kam ditur që po bëhet kjo vepër penale, asnjë cent nuk i kam borxh jam pagues i rregullt i energjisë elektrike, lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, për herë të parë jam para gjykatës.

Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se: e pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit u bë me vullnetin e tij të plotë pa kurrfarë presioni dhe konform dispozitave ligjore të KPPK-së, andaj i propozoi gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Pas leximit të aktakuzës Prokurori i Shtetit bën rikualifkimin e veprës penale nga vepra penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave, por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndjen shumë keqardhje për rastin, sjelljen e tij pas këtij rasti, si dhe premtimin se nuk do ta përsëritë më veprën penale, faktin se është mbajtës i vetëm i familjes, i pa punë, moshen e tijë të shtyer, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanarisht

2019:113061

rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj, gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të dispozitave të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave është marrë në bazë të nenit 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi propozimin e palës së dëmtuar për kërkesën pasurore-juridike është marrë në kuptim të dispozitave të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së**.**

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.187/2019 më dt.06.02.2020

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.

2019:113061